

THIRRJE PUBLIKE PËR FINANCIMIN
E PROJEKTEVE HULUMTUESE NË
SHKOLLAT FILLORE DHE TË MESME

SFIDA PËR
HULUMTUESIT E RINJ
5 – PROJEKTET E GJELBËRTA

SHKOLLAT E MESME PËRFITUESE



VENDI	EMRI I SHKOLLËS	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
Shkup	Shkolla e mesme "Vedra"	Kultivimi i mikroalgave në një mjedis të kontrolluar dhe përdorimi i tyre si pastrues natyral i ajrit dhe ujërave të zeza	Ky projekt parashikon krijimin e një fotobioreaktori për kultivimin e mikroalgave në një mjedis të kontrolluar. Ai do të përdoret për të hetuar efektivitetin e mikroalgave si një pastrues natyral i ajrit dhe ujërave të zeza. Në procesin e kultivimit, biomasa do të krijohet nga mikroalgat dhe përmes trajtimit të duhur do të shndërrohet në bionaftë. Nxënësit në projekt së bashku me mentorët e tyre do të hulumtojnë llojet e mikroalgave që kanë kapacitetin më të madh për të absorbuar dioksidin e karbonit dhe grimcat PM (si burim i nitrateve). Këto lloj mikroalgash do të kultivohen në fotobioreaktorin. Ai do të kontrollohet nga një mikrokontrollues i bazuar në teknologjinë Arduino dhe sensorë të përshtatshëm. Të gjithë parametrat e rëndësishëm do të maten dhe memorizohen për përpunim të mëtejshëm.
Kavadar	Shkolla e mesme "Kiro Spanxhov-Brko"	Akumulatori i Energjisë	Projekti "Akumulatori i Energjisë" paraqet një nevojë për të gjitha objektet që kanë burim energjie dhe përballen me energji të tepërt që nuk mund të ruhet dhe përdoret në maksimum. Ai do të hetojë se cilat materiale do të kenë vetitë më të mira të absorbimit të nxehtësisë, cilat lloje të modeleve të akumulatorëve të energjisë do të funksionojnë më mirë në klasë. Hulumtimi do të kryhet nga nxënësit dhe rezultatet e fituara do të jenë të zbatueshme në të gjitha shkollat e vendit, si dhe për mbrojtjen dhe përmirësimin e mjedisit në shoqëri.
Shkup	SHMSH për Rehabilitim dhe Edukim "Shën Naum Ohridski"	Nga mbetjet organike në erëza	Qëllimi kryesor i projektit është edukimi i nxënësve me aftësi të kufizuara se produktet ushqimore mund të përdoren në maksimum, pa krijuar mbetje. Pjesa kryesore për hulumtime dhe analiza në këtë projekt janë në fakt vetë mbetjet, të cilat ne i bëjmë çdo ditë, duke përdorur produktet ushqimore në ushqyerit tonë, dhe të cilat mund t'i ripërdorim duke përdorur teknologjinë moderne (dehidratues dhe bluarës) dhe t'i përdorim për të bërë erëza të dobishme që do të përdoren gjerësisht në kuzhinën tonë. Duke shfrytëzuar plotësisht mbetjet (dehidratimin, bluarjen dhe përgatitjen e erëzave shtëpiake), do të krijohet një erëz që do të ketë një aplikim të gjerë në ushqyerit tonë. Me këtë projekt nxënësit do të kenë mundësi për t'u njohur me teknologjinë moderne të përpunimit të ushqimit.

VENDI	EMRI I SHKOLLËS	EMRI I PROJEKTIT	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT
Shkup	SHMQSH Gjumnazi "Rade Jovçevski Korçagin"	Mikroprocesorët si mjete për mbledhjen e të dhënave dhe aplikimi i tyre në ekologji	Projekti "Mikroprocesorët si mjete për mbledhjen e të dhënave dhe aplikimi i tyre në ekologji" do të ekzaminojë përqendrimin e CO2, lagështinë dhe nivelin e dritës përmes matësve të përshtatshëm të vendosur në oborret e shkollave. Për këtë qëllim do të përdoret mikroprocesori si mjet. Matësit do të lidhen me procesorin i cili do të programohet për të përpunuar informacionet prej tyre. Me matjet e marra nxënësit do të kenë një pasqyrë të ndotjes së mjedisit dhe kjo u mundëson atyre të projektojnë masat e duhura në të ardhmen. Gjithashtu, përmes bashkëpunimit me shkollat e tjera, aktivitete të ngjashme inkurajohen edhe në mjedise të tjera shkollore. Duke i zbatuar këto metoda në afat të gjatë, do të merret një pasqyrë më e saktë se si faktorët e jashtëm evoluojnë me kalimin e kohës.
Shkup	Shkolla e mesme private "JAHJA KEMAL"	Ripërdorimi i llumeve të kafesë për panelet e absorbimit të zërit	Me këtë projekt nxënësit do të hetojnë se si mund të përdoren mbetjet, pra duke përdorur llum kafeje do të formohet një material i përbërë në formë paneli, i cili do të përdoret për absorbimin e zërit. Vendosja e këtyre materialeve të përbëra në muret e ambienteve që prodhojnë zhurmë do të kontribuojë në uljen e zhurmës që lidhet me cilësinë e jetës së popullatës vendase si dhe në parandalimin e hedhjes së llumit të kafesë në deponi, duke pasur parasysh se i njëjti është subjekt fermentimi gjatë së cilës lirohen gazra si metani dhe dioksidi i karbonit, të cilët kontribuojnë në efektin serë.
Shkup	SHMQSH Saraj	Eco warming life	Qëllimi kryesor i këtij projekti është t'i japë një zgjidhje afatgjatë problemit të ngrohjes qendrore në shkolla, veçanërisht gjatë stinës së dimrit, duke përdorur energjinë diellore, e cila është ekologjike për mjedisin, më ekonomike krahasuar me alternativat e tjera që kanë fatura dhe shpenzime më të larta për ngrohje. Me këtë projekt, nxënësit do të hetojnë se si mund të kursehet energjia elektrike dhe të mbrohet mjedisi përmes përdorimit të burimeve alternative të energjisë. Duke përdorur panelet diellore për funksionimin e kondicionerëve, do të kontribuojë në pastrimin e ajrit në klasë me jonizues, kursimin e burimeve financiare, uljen e ndotjes së mjedisit, si dhe programimin e kondicionerit për të punuar në një kohë të caktuar.